# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-427957**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kushtetuesja ndërhyn për pagat: Parlamenti duhet të zbatojë vendimet – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/kushtetuesja-nderhyn-per-pagat-parlamenti-duhet-te-zbatoje-vendimet/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 23:46:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 11:24:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `19711f18a0d9f82fe8cfdc8a00088d4bb282ff247cdc28dcb7d3245a222fbeaa` |
| TEKSTI | `9432cbc3ac7ffd02586695b6023419cadb463c92b60271c0ed13194c1dfd3ee2` |
| PAMJA | `2b18ab9fe21564800c987e85b272b2fe6468ff419c630097474f591290217eb7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `25d237fda0f0ca3bea4ad33e842a6e0aaee3f7d5a43d0a86d34cf516104b3535` |
| E MËPARSHMJA | `4bc6af23929cad9d5e8c4382138bf7824a46dfaf818b4dbea1cba0c97ef46617` |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/25d237fda0f0ca3bea4ad33e842a6e0aaee3f7d5a43d0a86d34cf516104b3535`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**“Gjykata ritekson se vendimet e saj janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Respektimi dhe zbatimi i tyre përbën një kërkesë të drejtpërdrejtë të rendit kushtetues dhe është i lidhur ngushtësisht me parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike”, thuhet në reagimin e Gjykatës Kushtetuese.**

Kushtetuesja vetë vendosi të mos kërkojë rritje page për muajin gusht dhe kjo u përdor nga ministria e financave për të argumentuar pse strukturat e thesarit bllokuan rrogat për gjyqtarët e prokurorët. Por vetë gjykata kushtetuese deklaroi se kjo zgjedhje e saj nuk është përcaktuese për zbatimin e vendimit që sanksionon se pagat e magjistratëve duhen rritur.

**“Gjykata sqaron se mënyra e përllogaritjes dhe e ekzekutimit të pagave në administrimin e brendshëm të saj, në varësi të fondeve buxhetore në dispozicion, nuk mund të interpretohet si përcaktuese për efektet juridike të vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 dhe as për detyrimet që ky vendim sjell për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij”, thuhet në reagimin e Kushtetueses.**

Në 17 shkurt gjykata kushtetuese rrëzoi formulën me të cilën qeveria përllogariste pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve; duke theksuar se gjatë viteve të fundit paga e tyre kishte pësuar ulje të fshehtë. Gjyqtarët urdhëruan parlamentin që deri në 31 korrik të miratojë një ligj të ri për pagën e magjistratëve duke garantuar rritjen e saj. Në vendimin e arsyetuar kushtetuesja mori masat edhe për rastet kur parlamenti nuk

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

vepron, duke sanksionuar se llogaritja e pagesave të prapambetura do të bëhet me formulën që i referohet funksionarit të administratës së lartë publike. por vendimi flet vetëm për pagesat e prapambetura e jo për pagqën e muajit gusht e në vijim.

Deri në 31 korrik parlamenti nuk miratoi asnjë ligj të ri për pagën e magjistratëve dhe në këtë situatë; qeveria e gjyqësorit, KLGJ e KLP vendosën të zbatojnë drejtpërdrejt vendimin e kushtetueses dhe miratuan rritjen e pagës së magjistratëve duke pasur si referencë funksionarin e administratës së lartë publike. Por dega e thesarit bllokoi pagat duke këmbëngulur se pa u miratuar ne parlament ligji i ri për pagat e magjistratëve, nuk mund të bëjë asnjë veprim.


**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.



Të gjithë artikujt


## Më shumë video



VIDEO

**"Smart City", Kumbaro: Kamerat...**

Xhuljana Zhuleku · 21 minuta më parë



VIDEO

**Nis shkolla, Kumbaro prezanton risitë në...**

Xhuljana Zhuleku · 33 minuta më parë



VIDEO

**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak...**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë


Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE





© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.